

LegalNews

SPECIAL

October 2021
Tetor 2021



I. Ligji nr. 79/2021 "Për të huajt"

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me datë 24.06.2021, ka miratuar Ligjin nr. 79/2021 "Për të huajt" (në vijim, "**Ligji**"), i cili shfuqizon Ligjin e mëparshëm me nr. 108/2013 "Për të huajt", i ndryshuar. Ligji është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 162, me datë 18.10.2021 dhe do të hyjë në fuqi me datë 02.11.2021.

Ligji synon, *ndër të tjera*, përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit legjislativ të migracionit, duke përafruar më tej atë me direktivat përkatëse të Bashkimit Europian, përmirësimin e mekanizmave të nevojshëm për lëshimin e vizave elektronike *on-line*, dispozitave ligjore në lidhje me ripranimet e të huajve, si dhe të menaxhimit të migracionit të parregullt.

Gjithashtu, Ligji ka përfshirë dispozita në kuadër të përmirësimit të të drejtave të të huajve, në drejtim të mbrojtjes së migrantëve dhe anëtarëve të tyre të familjes, refugjatëve, azilkërkuesve, si dhe garanton aksesin në programe dhe shërbime integrimi për të huajt.

Në krahasim me legjislacionin e mëparshëm, Ligji sjell risitë si në vijim:

A. Pajisja me leje unike:

Ligji parashikon një procedurë të vetme aplikimi për një leje të vetme për të huajt, që kanë për qëllim të punojnë dhe të qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Lejet unike lëshohen për qëllime/motive të ndryshme, psh., për qëllime punësimi, transferimi, formimi profesional, shërbime

I. Law no. 79/2021 "On foreigners"

The Parliament of Republic of Albania, on 24.06.2021, has approved the Law no. 79/2021 "On foreigners" (hereinafter, the "**Law**"), which abrogated the previous Law with no. 108/2013 "On foreigners", as amended. The Law is published with the Official Gazette no. 162, on 18.10.2021 and shall enter into force on 02.11.2021.

The Law aims, *inter alia*, the continuous improvement of the legislative framework of migration, by further aligning it with the relevant directives of the European Union, improving the necessary mechanisms for the issuance of electronic visas *on-line*, legal provisions regarding the readmission of foreigners, and also of the management of irregular migration.

In addition, the Law incorporates provisions in ambit of improving the rights of foreigners, in terms of protection of migrants and their family members, refugees, asylum seekers, and also ensures access to integration programs and services for foreigners.

In comparison with the previous legislation, the Law represents the novelties as follows:

A. Granting the unique permit:

The Law provides for a single application procedure for a single permit for foreigners, who intend to work and stay in the territory of the Republic of Albania. The unique permits are issued for different reasons/motives, i.e., for work purposes, assignments, vocational training, voluntary services, or for

vullnetare, apo qëllime investimi, etj. Kriteret për pajisjen me leje unike janë të ndryshme, në varësi të motiveve, për të cilat leja do të lëshohet.

B. Pajisja me leje qëndrimi për kategoritë e mëposhtme të të huajve:

- *Leje qëndrimi au pairs*, e cila u garanton të huajve nga mosha 18-30 vjeç, të cilët priten për kohësisht nga një familje, të pajisen me leje qëndrimi për një periudhë maksimale prej 1 (një) viti;
- *Leje qëndrimi për kërkimin e punës ose sipërmarrjen për kërkuesit shkencorë dhe studentët*, i jepet kërkuesve shkencorë dhe studentëve të huaj që të qëndrojnë të paktën 9 (nëntë) muaj, pasi të përfundojnë studimet ose kërkimet e tyre, për të kërkuar punë ose për të krijuar një biznes në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- *Leje qëndrimi për personat pa shtetësi*, duke garantuar një qëndrim të ligjshëm për këtë kategori, me përmbushjen e kërkesave ligjore, si dhe të kenë qëndruar të paktën 1 (një) vit në Shqipëri, përpara paraqitjes së kërkesës për aplikim;
- *Leje qëndrimi për pensionistë*, duke u siguruar shtetasve të huaj që janë në pension në vendin e tyre, mundësinë për të aplikuar për një leje qëndrimi për pensionistë në Shqipëri, nëse preferojnë vendin tonë si një destinacion për të jetuar, me një afat 1 (një) vjeçar për herë të parë dhe e rinovueshme për çdo vit;

investment purposes, etc. The criterias for granting a unique permit are different, depending on the motives, for which the permit will be issued.

B. Granting residence permit for the below categories of foreigners:

- *Residence permit au pairs*, which guarantees foreigners aged 18-30 years old, who are temporarily hosted by a family, to be provided with a residence permit for a maximum period of 1 (one) year;
- *Residence permit for job search or entrepreneurship for researchers and students*, is granted to foreign researchers and students to stay, at least 9 (nine) months, after completing their studies or research, in order to look for work, or to start a business in the territory of the Republic of Albania;
- *Residence permit for stateless persons*, guaranteeing a legal stay for this category, upon fulfillment of legal requirements, and also to have resided at least 1 (one) year in Albania, prior to filing the request for application;
- *Residence permit for retirees*, providing to foreign nationals, who are retired in their home country, the opportunity to apply for a residence permit for retirees in Albania, if they prefer our country, as a destination to live, with a term of 1 (one) year for the first time and renewable every year;

- *Leje unike qëndrimi për punonjës lëvizës digjital, të cilët janë shtetasit e huaj, që nuk punojnë në një vend fikse dhe si mjet kryesor pune kanë mjetet e teknologjisë së informacionit. Leja e qëndrimi lëshohet me një afat deri në 1 (një) vit, për herë të parë;*
- *Leje qëndrimi e përkohshme për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi në Republikën e Shqipërisë, i jepet të huajve, të cilët dëshmojnë pronësinë e një pasurie të tillë të paluajtshme.*

- *Unique residence permit for digitally mobile employees, who are foreign nationals, who do not work in a fixed location and they have as main means of work tools of information technology. The residence permit is granted with a term of up to 1 (one) year, for the first time;*
- *Temporary residence permit for exploitation of immovable property located in the Republic of Albania, is issued to foreigners, who prove the ownership of such immovable property.*

C. Pajisja me leje qëndrimi me afat 5-vjeçar për shtetasit si në vijim:

Përveç shtetasve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfitojnë leje qëndrimi me afat 5 (pesë) vjeçar, gjithashtu dhe shtetasit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të Republikës së Kosovës, kur aplikojnë për herë të parë dhe plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në Ligj.

C. Granting a 5-year residence permit for the following citizens:

In addition to the citizens of the United States of America, citizens of the member states of the European Union and the Republic of Kosovo, when applying for the first time and meet the general criteria set out in the Law, receive also a residence permit for a period of 5 (five) years.

D. Parashikimi i dispozitave në lidhje me fluturimet e përbashkëta:

Në kuadër të menaxhimit të migracionit të parregullt, veçanërisht politikave të kthimeve, Ligji integron për herë të parë në legjislacionin për të huajt, dispozita lidhur me fluturimet e përbashkëta, të cilat shërbejnë për transportin e shtetasve të vendeve të treta nga një transportues ajror i zgjedhur për këtë qëllim, si dhe në lidhje me operacionet e kthimit dhe kthimet e përbashkëta në rrugë ajrore.

D. Integration of provisions regarding joint flights:

In ambit of management of irregular migration, in particular of return policies, the Law integrates for the first time in the legislation for foreigners, provisions related to joint flights, which serve for the transport of third country nationals by an air carrier selected for this purpose, as well as regarding return operations and joint returns by air.

E. Përmirësim i dispozitave ligjore në lidhje me ripranimet:

Ligji përmirëson dispozitat ligjore në lidhje me ripranimet, si një detyrim ndërkombëtar i Republikës së Shqipërisë që të ripranojë të huajt e kthyer nga shteti, me të cilin ka një marrëveshje ndërkombëtare, sipas detyrimeve të përcaktuara në marrëveshje.

II. Aktet nenligjore

Së fundmi, aktet nënligjore, të cilat janë nxjerrë në zbatim të ligjit të mëparshëm nr. 108/2013 "*Për të huajt*", i ndryshuar, dhe që nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji do të zbatohen deri në miratimin e akteve të reja nënligjore të Ligjit.

Ligji ngarkon Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij brenda një periudhe prej 6 muajsh dhe ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike të nxjerrë udhëzimet përkatëse brenda një periudhe prej 3 muajsh nga hyrja në fuqi e Ligjit.

E. Improving legal provisions regarding readmission:

The Law improves the legal provisions regarding readmission, as an international obligation of the Republic of Albania to readmit foreigners returned from the country, upon which it has an international agreement, according to the obligations set out in the agreement.

II. Sublegal Acts

Lastly, the sub-legal acts, which have been issued pursuant to the previous law with no. 108/2013 and are not in conflict with the provisions of this Law, shall be implemented until the adoption of the new sub-legal acts of the Law.

The Law provides that the Council of Ministres should approve the sublegal acts within 6 months while the ministry responsible for public order and safety should approve the relevant instructions within 3 months from the entry into force of the Law.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Sabina Lalaj

Local Legal Partner
Deloitte Legal sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mobile: + 355 68 37 33 130
E-mail: slalaj@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.